



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr 3139 prot

Gramsh, më 06/08 / 2025

URDHËR

Nr 268 datë 06/08 / 2025

PËR

“Caktimin e Zyrës së Gjëndjes Civile, pranë Bashkisë Gramsh, për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”

Mbështetur në ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, neni 9 si dhe neni 64 i tij; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 843, datë 26.12.2024, “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”; Bashkia Gramsh:

URDHËROJ

- I.** Caktimin e Zyrës së Gjëndjes Civile, pranë Bashkisë Gramsh, për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare
- II.** Detyrat e Zyrës së Gjëndjes Civile:
 - Mbledhja e të dhënave për identifikimin e personave, që i përkasin pakicave kombëtare, të kryhet në përputhje me të drejtën e tyre për vetidentifikim të lirë.
 - Personi, që pretendon se i përket një pakice kombëtare dhe kërkon të identifikohet si i tillë, të pajiset me formularin e vetidentifikimit, sipas aneksit 1, të VKM-së nr. 843, datë 26.12.2024.
 - Formularët e vetidentifikimit të administruar nga ZGjC, t'i përcillen komisionit të ngritur në ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e një pakice kombëtare sipas VKM-së nr. 845, datë 26.12.2024.
 - ZGjC, të ketë në konsideratë ruajtjen e kofindicjalitetit për të dhënat e vetdeklaruara.
- III.** Sektori i IT, performacës dhe statistikave si dhe Policia Bashkiake të bëjnë shpalljet përkatëse të VKM-së nr. 843, datë 26.12.2024 për qytetarët.
- IV.** Mos zbatimi i këtij Urdhëri Ju ngarkon me përgjegjësi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

